

VENDIM
Nr.190, datë 9.3.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1065, DATË 29.12.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E KRYERJES SË RIMBURSIMIT
NGA TAKSA E BIZNESIT TË VOGËL TË PAGESËS PËR PAJISJET FISKALE DHE
TAKSIMETRAT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1065, datë 29.12.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “b” e pikës 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Kopjen e kontratës me një nga “Shoqëritë e autorizuar” nga Ministri i Financave, për ofrimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve fiskale në rastin e pajisjeve fiskale.”.

2. Pas pikës 2 shtohen pikat 2.1 dhe 2.2, me këtë përmbajtje:

“2.1. Në rastet kur tatimpaguesi ka blerë pajisjen fiskale nga “Shoqëria e autorizuar”, Bashkimi i Operatorëve PKP & Rilindja, sh.p.k., për blerjet deri në datën 26.7.2010, datë në të cilën kësaj kompanie i është hequr autorizimi nga Ministria e Financave, tatimpaguesi duhet të dorëzojë pranë zyrës së taksave të bashkisë apo të komunës, ku është i regjistruar, dokumentacionin e paraqitur në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 2, përmendur më lart, të këtij vendimi.

2.2. Tatimpaguesi, që ushtron veprimtari në ofrimin e shërbimit të taksisë, duhet të dorëzojë pranë zyrës së taksave të bashkisë apo të komunës, ku është i regjistruar, brenda datës 31 mars 2011, formularin e rimbursimit të pagesës për taksimetrit, sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi, së bashku me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kopjen e faturës së blerjes së taksimetrit.

b) Kopjen e kontratës me shoqërinë shitëse të taksimetra (nëse disponohet).

c) Kopjen e njoftim - vlerësimit tatimor për vitin ushtrimor, të lëshuar nga zyra e taksave të bashkisë ose të komunës.

ç) Faturën e plumblosjes që vendoset nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë.”.

3. Fjalja e fundit e pikës 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Procedura e këtij rimbursimi është e njëjtë, si në rastin e rimbursimit për pajisjet fiskale, të përcaktuar në këtë vendim.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha